



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA KRUIJË  
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Krujë ,më. 14.06.2024

**PROCESVERBAL – KONTRATE MALLI**  
**ME OBJEKT**

**“ BLERJE KARBURANT, ARTIKULLI GAZOIL 10 PPM PËR  
BASHKINË KRUIJË ”**

**PËR ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR  
KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

I mbajtur sot me date 14.06.2024 ne Kruje ,nga ana e Njesise se Prokurimit te ngritur me urdherin **nr.216 datë 27.06.2024** me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit ‘E Hapur ’, me te dhenat si vijon:

**Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “ Blerje karburant, artikulli gazoil 10 ppm për Bashkinë Kruje ”**

**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): FPP 09100000-0 Karburante.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 13 312 689 ( trembedhjete milion e treqind e dymbjedhete mije e gjashteqind e tetedhete e nente ( leke pa t.v.sh**

**BURIMI FINANCIMIT :TE ARDHURAT E BASHKISE KRUIJE .**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (2% e vlerës së fondit limit të kontratës).

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

#### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

**1-a)**Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2024 të njohura nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatorëve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2024 për secilin operator)*

**Shenim-**Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8, ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2024 të leshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatorëve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore për secilin operator).*

#### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 ). duke e plotësuar bashkëlidhur me një deklaratë Referuar Ligji 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” , Operatori ekonomik duhet te kete të regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; operatori ekonomik duhet te kete përmbushur detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për pagat; operatori ekonomik nuk duhet te kete asnjë anëtar te një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, i operatorit ekonomik, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij; te dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

**a) Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet e fundit ushtrimore/ financiare (2021.2022.2023 ) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te kontrates, qe prokurohet ,përkatësisht ne shumen prej **5 325 076 (pese million e treqind njezet e pese mije e shtatedhjetë e gjashtë ) leke pa t.v.sh****

Shenim-Pika 2.2-a) plotësohet duke paraqitur edhe vertetimin perkates te Administrates Tatimore

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43.2.c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-se nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike.

---

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e

---

mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë: Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme me vlerë totale 20% të vlerës së përlogarit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, perkatesisht në Shumen

Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik kerkohen - vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara (sipas shtojces nr.9).

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e vlerës jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

---

**2.3.2.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë raport analize nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) për mallin objekt prokurimi, ku vlerat e treguesve të analizuar të perputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Raport analiza nga ISHTI duhet të jetë lëshuar jo më parë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e hapjes së ofertave.

**Argumentimi:** Referuar nenit 40 pika 6/c, 43 dhe 44 të VKM 285 date 19.05.2021. Keto certifikime janë tashme një standard gjerësisht i kërkuar në fushën e prokurimeve publike, i mundëson AK për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore, dhe se ka të gjitha certifikimet mbi cilësinë sipas kërkesave të procedurës së prokurimit.

---

**2.3.3.** Operatori duhet të ketë minimalisht 1 \*një\* stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Krujë, pasqyruar tek të dhënat në QKB, vertetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie) për këtë stacion.

---

**Shenim:** Për piken me sipër, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas **shtojces nr.8**.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara njoftimit të fituesit, të gjithë dokumentacionin provues për vetedeklarimet në formularin përmbledhës të vetedeklarimit.

**Argumentimi:** Referuar nenit 40 pika 6/c, 43 dhe 44 të VKM 285 date 19.05.2021. Keto certifikime janë tashme një standard gjerësisht i kërkuar në fushën e prokurimeve publike, i

mundeson AK per te verifikuar dhe krijuar besimin qe OE ofertues eshte ne gjendje te realizoje punen/sherbimin ne menyre cilesore, dhe se ka te gjitha certifikimet mbi cilesine sipas kerkesave te procedures se prokurimit.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet te deklaroje se merr persiper te furnizojë ne stacionin te shitjes se karburanteve me pakice me sherbim 24 ore ne cdo dite te javes, me karte elektronike te personalizuar me targen e cdo automjeti te autoritetit kontraktor, sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor. Subjekti merr persiper qe te konvertoje te gjithë sasine e litrave te ndodhura ne karten elektronike te personalizuar me targen e mjetit, deri ne perfundimin e plote te kontrates , sipas nevojave te Autoritetit Kontraktor. Karta elektronike duhet te jete pa skadence dhe te jete e perdorshme dhe gjate vitit 2024.

Shenim Per plotesimin e kriterit te mesiperm te pikes eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

---

**2.3.5.** Operatori ekonomik pjesemarres duhet te ofrojë nje faqe menaxhimi te karburanteve te cilën duhet ta prezantoje ditën e hapjes se ofertave, ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per automjetet, ne rastin kur te kerkohet nga Autoriteti Kontraktor, te kryhet nepemjet kartes elektronike, si dhe te krijojë mundesine e sherbimit te ngarkimit te sasise se karburantit nga operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targen e mjetit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vete Autoriteti Kontraktor. Faqja duhet te mundesoje sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike, pulla te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet.

---

**Argumentimi:** Referuar nenit 40 pika 6/c, 43 dhe 44 te VKM 285 date 19.05.2021. Keto certifikime jane tashme nje standart gjeresisht i kerkuar ne fushen e prokurimeve publike, i mundeson AK per te verifikuar dhe krijuar besimin qe OE ofertues eshte ne gjendje te realizoje punen/sherbimin ne menyre cilesore, dhe se ka te gjitha certifikimet mbi cilesine sipas kerkesave te procedures se prokurimit.

**2.3.6.** Operatori ekonomik duhet te tarqese License te vlefshme per tregtimin e karburanteve e leshuar nga Ministria perkatese ose autorizim te vlefshem per tregtimin e karburanteve te leshuar nga Njesite e Qeverisjes Vendore.

---

**Argumentimi:** Referuar nenit 40 pika 6/c, 43 dhe 44 te VKM 285 date 19.05.2021. Keto certifikime jane tashme nje standart gjeresisht i kerkuar ne fushen e prokurimeve publike, I mundeson AK per te verifikuar dhe krijuar besimin qe OE ofertues eshte ne gjendje te realizoje

punen/sherbimin ne menyre cilesore, dhe se k ate gjitha certifikimet mbi cilesine sipas kerkesave te procedures se prokurimit.

---

Kerkesat e mesiperme jane vendosur nga ana e AK ne perputhje me nenin 44.2 e vijues te VKM nr 285 date 19.05.2021 nepermjet te cilave kerkohet qe Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron furnizime me karakteristika specifike ose specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Lista e artikujve te cilet do blihen jane si vijon te detajuara me specifikimet teknike perkatese*

Artikulli	Përshkrimi	Shuma/leke	Destinacioni	Periodha e dorëzimit
1	<b>Gazoil per automjetet e Bashkise Kruje</b>	<b>13 312 689</b>	<b>Bashkia Kruje</b>	<b>deri 31 Dhjetor 2024</b>

- Hartimi i specifikimeve teknike për blerjen e artikullit te mesiperm është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorise se Sherbimeve dhe Investimeve Publike qe mban **nr.3460 Prot, date 03.06.2024**, duke identifikuar specifikimet standarte dhe karakteristikat perkatese teknike.te cilat plotesojne nevojat respektive te Bashkise Kruje dhe me konkretisht ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te VKM nr.147, datë 21.03.2007 “ Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzine dhe diesel ”. Operatori ekonomik fitues bazuar ne “ *Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.561 date 29/07/216 Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme* ” , ne njoftimin nr 2123 date 31.01.2017 te APP,
- **Furnizimi me karburant duhet te garantohet sipas standarteve shtetërore në fuqi, SSH EN 590 2018 per Gazoil (10 ppm )**
- **Fondi limit per proceduren me objekt “ Blerje karburant, artikulli gazoil 10 ppm, per automjetet e Bashkisë Krujë ”**, eshte hartuar duke iu referuar cmimeve te Buletinit te Agjensise se prokurimit publik date 20.05.2024, kursin e kembimit te Bankes se Shqiperise date 16.05.2024 dhe kontrata e meparshme nr.3340 prot date 12.04.2023

,sipas referimeve dhe metodave te parashikuara ne nenin 76.c te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 , “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

## **NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK**